



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

Në vijim të shqetësimeve të ngritura në media mbi zbatimin *Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”*, inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës në datën 12.07.2023 u paraqitën përsëri pranë aeroportit ndërkombëtar të Tiranës për të monitoruar zbatimin e këtij vendimi.

Gjatë monitorimit është evidentuar se në zonën “Kiss & Fly” ose ndryshe zona 4 minutshe (pa pagesë) **lejohen të kenë akses/hyrje të gjithë ndërmarrjet e taksive me ose pa pasagjerë për të marrë ose për të lënë udhëtarë** nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

Gjithashtu, ndërmarrja TIA SHPK, ka zbatuar të pikën “b” të VKK nr. 987/2023, për heqjen e tabelës me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”.

**Theksojmë se**, objekt i hetimit nga Autoriteti i Konkurrencës sipas *Vendimit nr. 984, datë 11.5.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”*, lidhet me mundësinë për të lënë dhe për të marr pasagjerë me akses të palimituar dhe jo me vendqendrimin afat gjatë të taksive në këtë zonë.